

VENDIM
Nr. 208, datë 10.4.2019

**PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, KOMPETENCAT DHE
SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

Ky vendim ka për qëllim të rregullojë përbërjen, mënyrën e funksionimit, ushtrimin e kompetencave dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

II. Përbërja dhe organizimi i këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. KKTKJ-ja përbëhet nga 15 anëtarë: nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që e kryeson, dhe 14 anëtarë që emërohen prej tij.

3. Anëtarë të KKTKM-së janë:

- a) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- b) përfaqësues të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) 3;
- c) përfaqësues nga drejtoritë përgjegjëse për çështjet e trashëgimisë kulturore në ministrinë përgjegjëse për kulturën 2;
- ç) përfaqësues të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK) 1;
- d) jurist i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore 1;
- dh) personalitete të fushës së arkeologjisë 2;
- e) përfaqësues nga Universiteti i Tiranës 2;
- ë) personalitete të fushës së trashëgimisë kulturore materiale, të cilët kanë një eksperiencë të pasur profesionale ose akademike në disiplinat e arkeologjisë, restaurimit dhe konservimit të pasurive kulturore materiale, trashëgimisë arkitektonike apo menaxhimit të trashëgimisë kulturore materiale 3.

4. Anëtarët e KKTKM-së përmbushin detyrën e përgjegjësitë e tyre dhe deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

5. Mandati i anëtarit të KKTKM-së është 2 vjet, me të drejtë riemërimi. Anëtari qëndron në detyrë dhe përmbush funksionet deri në emërimin e anëtarit të ri.

6. Anëtari i KKTKM-së, i parashikuar në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 3, të këtij kreu, propozohet nga titullari përkatës, duke u bazuar në kriteret, si më poshtë:

- a) të jetë nëpunës/punonjës i nivelit drejtues të një drejtorie ose sektori;
- b) të gëzojë reputacion të lartë profesional;
- c) të ketë njohuri për trashëgiminë kulturore materiale;
- ç) të ketë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucionet e trashëgimisë kulturore;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale;

7. Anëtari i KKTKM-së, i parashikuar në shkronjat “dh”, “e” dhe “ë”, të pikës 3, të këtij kreu, propozohet nga titullari përkatës, duke u bazuar në kriteret, si më poshtë:

a) të jetë nga radhët e personelit akademik, i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme në institucionet e arsimit të lartë, publik ose privat, të licencuar dhe akredituar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

b) të kenë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

c) të zotërojnë tituj akademikë.

8. Mandati i anëtarit të KKTKM-së mbaron, kur:

a) përfundon afati 2-vjeçar, nga emërimi;

b) lirohet nga funksioni zyrtar, përveç personaliteteve nga fushat e trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë;

c) jep dorëheqjen.

9. Anëtari i KKTKM-së lirohet nga detyra para mandatit, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore,:

a) kur nuk paraqitet, pa shkak të justifikuar, në 5 mbledhje të njëpasnjëshme të KKTKM-së;

b) për shkaqe objektive, që e bëjnë të paafte për të kryer funksionet e ngarkuara;

c) kur nuk përmbush detyrimet si anëtar i KKTKM-së;

ç) kur dënohet me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) kur veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KKTKM-së.

10. Pranë KKTKM-së funksionojnë këto struktura administrative:

a) këshilli teknik;

b) sporteli unik;

c) sekretaria teknike.

11. Këshilli teknik është organ kolegjal seleksionues, vlerësues e vendimmarrës, që ka në përbërje 7 anëtarë, të cilët janë pjesë e 15 anëtarëve të KKTKM-së.

12. Këshilli teknik kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe vepron si trupë shqyrtuese dhe seleksionuese e përputhshmërisë së kërkesave të paraqitura pranë KKTKM-së. Vendimi ose relacioni që i dërgohet KKTKM-së nga ana e Këshillit teknik firmoset nga kryetari.

13. Këshilli teknik ka kompetencë të miratojë kërkesa që lidhen me ndërhyrjet me karakter mirëmbajtje të pasurive kulturore, sipas listës së ndërhyrjeve të miratuara nga KKTKM-ja.

14. Për çështje të tjera, që, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 janë kompetencë e KKTKM-së, këshilli teknik, pasi shqyrton përputhshmërinë e kërkesave të paraqitura, miraton relacionin përkatës, të hartuar nga sekretaria teknike, dhe ia përcjell për vendim Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

15. Sporteli unik është pjesë e strukturës administrative pranë IKTK-së, ku depozitohen të gjitha kërkesat për aplikim, për të cilat është kompetente KKTKM-ja. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

16. Sekretaria teknike është pjesë e strukturës administrative të IKTK-së, në funksion të KKTKM-së, e cila administron kërkesat dhe përgatit dokumentacionin për vendimmarrje të KKTKM-së. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

III. Funksionimi i këshillit

1. KKTKM-ja mbledhet jo më pak se një herë në 2 muaj. Mbledhjet e këshillit thirren nga kryetari dhe njoftimi përcillet nga sekretaria teknike, të paktën, 3 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Në raste të veçanta, mbledhja mbahet edhe në një ditë të ndryshme nga ai i njoftimit, kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët dhe miratojnë, paraprakisht, zhvillimin e mbledhjes. Vendimi reflektohet në procesverbalin e mbledhjes.

2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes përmban vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Njoftimit i bashkëlidhet edhe relacioni i këshillit teknik si dhe materiale të tjera, lidhur me çështjet e rendit të ditës. Rendi i ditës miratohet nga kryetari.

3. Mbledhja e këshillit mund të kërkohej edhe nga 1/3 e anëtarëve, duke i drejtuar kërkesë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Zhvillimi i mbledhjes, në këtë rast, miratohet nga kryetari dhe u njoftohet të gjithë anëtarëve.

4. Mbledhjet e KKTKM-së zhvillohen gjithmonë në prani të kryetarit dhe janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse.

5. KKTKM-ja vendos me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të vendimeve për miratimin e lejes për ndërhyrje, sipas nenit 80, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, për të cilën vendos me shumicë absolute.

6. Vendimet e KKTKM-së merren me votim të hapur. Anëtarët e KKTKM-së, që janë të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë.

7. Kryetari i KKTKM-së voton i fundit. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

8. Vendimet e KKTKM-së nënshkruhen nga kryetari dhe siglohen nga sekretari i KKTKM-së.

IV. Kompetencat e këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 38, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ka këto kompetenca:

a) licencën dhe u revokon licencën subjekteve, personave fizikë apo juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore, në projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim, vlerësim, veprimtari arkeologjike, të arkeologjisë së shpëtimit dhe arkeologjisë nënujore;

b) miraton projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim;

c) mbikëqyr veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore materiale dhe të pasurive të peizazhit;

ç) miraton lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe lejet e parashikuara në këtë ligj;

d) miraton, në parim, kërkesën për deklarimin e interesit kulturor;

dh) miraton, në parim, shpalljen e qendrave historike, të parqeve e zonave arkeologjike dhe zonat mbrojtëse të pasurive kulturore;

e) harton akte të karakterit të përgjithshëm, me qëllim sigurimin e uniformitetit të vlerësimit të interesit kulturor;

ë) miraton, vlerëson, në parim, planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore;

f) këshillon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore gjatë shqyrtimit prej tij të kërkesave të subjekteve të veçanta për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona me pasuri kulturore;

g) autorizon institucionet e specializuara dhe/ose subjektet e licencuara për përdorimin e aparaturave metalkërkuese për kryerjen e gërmimeve me karakter arkeologjik;

gj) miraton dhe revokon lejet për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike;

h) miraton planet e zhvillimit, të projekteve restauruese e konservuese dhe projektet kërkimore-shkencore të njësive të administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike;

i) miraton hulumtimet arkeologjike sistematike, me karakter kërkimor-shkencor, dhe hulumtimet arkeologjike parandaluese e të shpëtimit;

j) miraton dhe revokon lejet për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike nënujore;

k) vendos për vijueshmërinë e punimeve në rastin e gjetjeve rastësore, sipas neneve 145 e 146, të ligjit nr. 27/2018;

l) këshillon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim;

ll) shprehet me vendim për kërkesat për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të pasurive kulturore, në përputhje me kompetencat e saj;

m) Shprehet lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit dy ose shumëpalëshe ndërmjet institucioneve vendase dhe të huaja apo subjekteve të licencuara për kryerjen e veprimtarive hulumtuese;

n) miraton projektet e zhvillimeve transformuese në territor, sipas nenit 134, të ligjit nr. 27/2018;

nj) miraton dhënien në përdorim, në formën e rjetëzimit, të pasurive kulturore të regjistruara si pasuri kulturore “me rëndësi kombëtare”, sipas nenit 183, të ligjit nr. 27/2018;

o) shprehet me vendim për verifikimin e interesit të veçantë publik të pasurive të peizazhit kulturor;

p) miraton projektet për ndërhyrje në pasuritë e peizazhit kulturor, sipas nenit 251, të ligjit nr. 27/2018;

q) merr vendim për përcaktimin e distancave, të masave/hapësirave dhe varianteve të projektit në fazë ekzekutimi, të nevojshme për të siguruar ruajtjen e vlerave të pasurive të peizazhit kulturor;

r) çdo kompetencë tjetër, të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore.

2. Këshilli teknik shprehet me vendim përfundimtar lidhur me kërkesat për ndërhyrjet me karakter mirëmbajtjeje. Llojet e ndërhyrjeve, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të KKTKM-së.

3. KKTKM-ja shqyrton kërkesën për deklarimin e interesit kulturor ose për miratim, në parim, të vendimit për shpalljen e qendrave historike, të parqeve dhe zonave arkeologjike, mbi bazën e vendimit të komisionit këshillimor, përkatës, për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore, të ngritur sipas nenit 59, të ligjit nr. 27/2018. Institucioni i specializuar, përkatës, përcjell për miratim, në parim, pranë KKTKM-së vendimin e komisionit dhe dokumentacionin shoqërues.

4. KKTKM-ja miraton dhe vlerëson, në parim, planet e përgjithshme e të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, si dhe lejet zhvillimore përpara miratimit të tyre nga organet kompetente, në bazë të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

V. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit

Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin normativ të masës së shpërblimit të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore.

VI. Dispozitat të fundit dhe tranzitore

1. Aplikimet e nisura për shqyrtim dhe vendimmarrje nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve (KKR) dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA) trajtohen sipas akteve të krijimit të KKR-së dhe KKA-së, deri në ngritjen e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK).

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe institucionet e tjera në fushën e trashëgimisë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe